

Nexhdet  
Deveja

BUR

RIM

MET

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-1  
845

viersha

8JH-1  
845

NEXHDET DEVEJA

# BURIMET

vjersha



12065

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: **Vehbi Skënderi**

Kopertina nga: **Svjetllana Strazimiri**



---

Tirazhi 1.500 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204 - 72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

## CAST PUSHIMI

*N ē z b o r*

Jam shtrirë mbi barin e njomë  
e dëgjoj zërat e natyrës.

Qetësi.

Të gjithë pushojnë.

Pushkët i këmi kulmuar tok.  
Mbi pushkët tonë këndon një zog.

## M I M O Z A

E heshtur qëndron ti, atje ku të kanë mbjellë,  
në një trotuar, në një oborr shkolle a në një uzinë,  
në një lulishtë, a në një shesh të ri.

Ke hapur krahët dhe ngjyrën e artë ia ke rrëmbyer  
natyrës,  
në nuancat më të bukura, në shkëlqimet më të  
ndritura.

E ke mbledhur atë bukuri në kokrriza botësh të  
vogla.

dhe e ke veshur me aromën e ëmbël freskuese,  
që e përhap rreth vetes valë-valë.

Vallë, e di ti,  
se ke kaq bukuri?

I ndjen ti vështrimet e vajzës së gëzuar?  
Prekjet e saj të lehta kur këput me kujdes një bisk?

Ia dëgjon ti rrahjet e zemrës në ato çaste,  
ëmbëlsinë e syve të saj, dashurinë e syve të saj?

O, mos i folë vajzës së dashuruar.  
Dashuria kërkon bukurinë, gëzimin, lirinë...  
Dashuria kërkon dashurinë.  
Lere Mimozen t'i mbushë me mimoza ato duar.

Ti ke aq shumë lule në duart e tua...  
aq bukuri... aq ëmbëlsi...  
Falmë mimoze një lule edhe mua,  
dhe merre këtë poezi.

## V J E S H T È

Dielli zurret nga kulmi.  
Era vrapin e shpejton.  
Jashtë e brenda ulet barometri.  
Pema gjethet i lëshon...

Shiu nis e s'di të pushoje.  
Majëmalesh dimri zgjat kovën të shikojë.

## Z G J I M

Nata ende fle mbi qytet.

Mjegulla rrugët i ka mbuluar.

Një dritare çel syrin në apartament.

Nëpër xama drita shpon natën e përtuar.

Një motor buçet përtej me uturimë.

Maqina nëpër asfaltin e lagur rrëshqet.

Dy dritare të tjera hedhin dritë mbi rrugë, atje në kthinë.

Qyteti nis të zgjohet.

Prozhektorët e maqinave çajnë errësirën nëpër rrugë.

Apartamentet çelin sytë e ndritshëm një nga një.

Nata përton të ngrihet. Po dritat e kanë shpuar shumë...

Qyteti mbushet me jetë.

## KËNGA PARTIZANE

Një këngë dëgjohet jashtë në rrugë,  
dal në dritare edhe shoh:  
djem e vajza, në rresht me pushkë.  
Kënga e tyre zemrën ma ngroh.

Ç'më shtyn kjo këngë në vitet e shkuara,  
rininë e zjarrtë më kujton.  
O, sa herë këtë këngë e kam kënduar  
me shokët, në luftë, në pozicion.

O këngë e luftës partizane,  
këngë e zemrave barot,  
zjarr u ndeze atëhere në male,  
zjarr i ndez zemrat edhe sot.

## S H T E T R R E T H I M

1

Trak — trak... Trak — trak...

Katër çizme, mbërthyer me thumba, trokasin mbi  
kalldrëm.

Nën dritat e zbehta të rrugës, dy hije zvarriten si  
gjarpéri.

Dridhen, zgjaten, ngjiten, mblidhen,  
mbi mure, mbi dyer, lidhen si lak.

Natë e rëndë. Qiell i nxirë. Heshtje e vrarë.

Qyteti duket pa jetë — qytet me mure të shkreta —  
(si pas një rrëmeti mbytës kaluar).

Pa një rrahje,

pa një ngjitje,

veç mbi kalldrëm të vdekjes trokitje:

Trak — trak... Trak — trak...